



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

**KUVENDI KOMUNAL PEJË**

**I.Numër: 05-160/01-24676, dt. 29 Maj 2025.**

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 12 al. 2. pika d) të Ligjit Nr. 03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28. datë: 04. Qershor 2008"), nenit 3 paragrafi 3.5. të Rregullores Nr. 02/2016 për tituj të nderit, dekorata, medalje, mirënjohje dhe falënderime dt. 01. Prill 2016, dhe nenit 13 paragrafi 1. pika 1.20. të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 të dt: 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të Komisionit të kuvendit dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

**VENDIM**

**Nr. 51/2025**

**Për dhënien e titullit "Azem Shkreli" Post Mortum**

**Prof. Sylë Osmanaj**

1. **Prof. Sylë Osmanaj**, nga Peja, i jepet titulli **"Azem Shkreli" Post Mortum**, me motivacion:

"Për kontributin e tij në krijimtarinë letrare, poezi, gazetari dhe në edukimin e brezave të rinj në Kosovë, duke lënë një gjurmë të veçantë dhe duke përgatitur breza të tërë. Falë ekspertizës dhe njohurive që zotëronte, kontribuoi në ngritjen e vetëdijes kolektive, sepse e donte vendin dhe atdheun e tij, prandaj dhe ishte jashtëzakonisht i përkushtuar në edukimin e brezave sepse, sipas tij, historia dhe shteti lindin në shkollë".

2. Ky fakt do të evidentohet në regjistrin e veçantë të qytetarëve të dekoruar nga Komuna e Pejës, të cilin e mban Kuvendi Komunal dhe kryetari i Komunës.

3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Pejës.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Ueb faqen zyrtare të Komunës së Pejës.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**Z. Rexhep Kurtbogaj**